

Llapushnikë/Lapušnik. Familjarët janë ende duke kërkuar ndriçimin e fatit të Željkos. Zhdukja e tij është evidentuar nga KNKK-ja dhe lënda e tij e mban numrin rendor YUK-050014-01.

Burimet: deklarata V.B, FDH-18959; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; AIS, *Zona...*, 61, FDH-16913; SMIP, *Teroristički...*, III, 962, FDH-9087.

Živorad (Jeremija) Krstić

(7.11.1930, serb nga Prishtina/Priština, tre fëmijë, pensionist)

Srboljub (Nikola) Miladinović

(14.10.1967, serb nga Reçani/Reçane, komuna e Suharekës/Suva Reka, dy fëmijë, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Živoradi ka lindur në fshatin Mushnikovë/Mušnikovo [Prizren], por jetonte në Prishtinë/Priština, në lagjen *Aktash I*. Vuante rëndë nga sëmundja e diabetit dhe duhej të merrte rregullisht insulinë. Pas mbarimit të shkollës së mesme, Srboljubi merrej me biznes privat për disa vjet, ndërkaq, më vonë, e përfundoi trajnimin për forcat policore. U punësua në Sekretariatën për Punë të Brendshme në Shtimë/Štimlje. Në kohën kur filloi lufta në Kosovë, ai nuk punonte sepse ishte suspenduar nga detyra. Në mëngjesin e datës **25.06.1998**, Živoradi dhe Srboljubi u nisën me autobusin e *Mamusha (Mamuša) Tursit* nga Prizreni për në Prishtinë/Priština. Živoradi po kthehej nga shënimi i përvjetorit të vdekjes së vëllait, ndërkaq Srboljubi shkonte për t'i vizituar prindërit e bashkëshortes. Nga ora 11:30, diku në mes të Carralevës/Crnoljevo dhe Duhlës/Dulje, pjesëtarë të UÇK-së e kanë ndaluar autobusin dhe e kanë marrë jashtë Živoradin dhe Srboljubin. Srboljubi tentoi që të arratisë dhe pjesëtarët e UÇK-së shtënë drejt tij duke e plagosur në këmbë. Më pas, i morën që të dy dhe i çuan në drejtim të panjohur. Srboljubin dhe Živoradin i fundit i shihje të gjallë Vojko Bakrač në kampin e të burgosurve të UÇK-së në **Llapushnik/Lapušnik**. Familjarët e tyre janë ende duke kërkuar ndriçimin e fatit të tyre. Në listën e të zhdukurve të KNKK-

së, rasti i Živoradit është evidentuar me numrin rendor YUK-050028-01, ndërsa ai i Srboljubit me numrin YUK-050027-01.

Burimet: deklarata Z.M, FDH-28675; deklarata V.B, FDH-18959; ICTY, IT-03-66 (F. Limaj dhe të tjerë), aktgjykimi, 30.11.2005, [http://www.hlc-rdc.org/index.php?lid=sr&show=PravdaIReforma&int_cid=119&cat=Transkripti/Predmet-Limaj-i-drugi\(-IT-03-66-\);](http://www.hlc-rdc.org/index.php?lid=sr&show=PravdaIReforma&int_cid=119&cat=Transkripti/Predmet-Limaj-i-drugi(-IT-03-66-);) deklarata V.B, FDH-18959; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795; AIS, *Zona...*, 60, FDH-16913; SMIP, *Teroristički...*, III, 961; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817.

Đorđe (Obrad) Ćuk

(15.01.1973, serb nga Gjakova/Đakovica, punëtor)

Stamen (Tase) Genov

(3.09.1974, bullgar nga Gjakova/Đakovica, teknik mjekësor, pjesëtar i Ushtrisë së Jugosllavisë)

Stameni ka qenë me origjinë nga fshati Lubata e Epërme të qytetit të Bosilgradit. Pas përfundimit të shkollës së mesme mjekësore, u punësua në ambulancën ushtarake në Gjakovë/Đakovica. Đorđe ishte refugjat nga Ruishta [Kroacia]. Në fillim të vitit 1995, në kohën e operacionit të ushtrisë kroate *Stuhia/Oluja*, ai së bashku me prindërit Obradin dhe Smiljen, vëllain Veljkon dhe motrën Draganen e kishin braktisur Kroacinë. Në fillim, u strehuan në qytezën Oxhaci, në Serbi. Më vonë kaluan në Kosovë, ku u strehuan në Gjakovë/Đakovica, në kuadrin e strehimit kolektiv në shkollën teknike.

Në datën 29.06.1998, Stameni dhe Đorđe po udhëtonin me autobus të *Gjakova (Đakovica) transportit*. Stameni po shkonte në Beograd, ku e kishte të caktuar provimin pranues në Fakultetin e Mjekësisë, ndërkaq Đorđe ishte nisur për në Prishtinë/Priština, ku e kishte intervistën në UNHCR, lidhur me aplikimin e tij për emigrim në Kanada. Në fshatin e Carralevës/Crnoljevo [Shtimë/Štimlje], te xhamia e fshatit, autobusin e kanë ndaluar pjesëtarët e UÇK-së. Pas identifikimit, ata e kanë marrë jashtë Stamenin, Đorden, Vojko Bakračin me djalin Ivanin. Këta dy të fundit u prezantuan si kroatë. Nga ky vend, së pari i kanë çuar në një shkollë të fshatit, ku Stamenin